

KUR INSTITUCIONET HESHTIN DHE DREJTËSIA VONON

Dhjetor 2024





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) - degë e Transparency International (TI), është organizatë jo-qeveritare e cila ka për qëllim kryesor fuqizimin e qytetarëve për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie publike dhe për tu përfshirë në politikëbërje. Aktivitetet tona shtrihen në fushat e demokratizimit dhe praktikave parlamentare, sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit, qeverisjes lokale dhe zgjedhjeve.

Në kuadër të KDI-së që nga viti 2015 funksionon Qendra për Avokim dhe Ndihmë Ligjore falas (ALAC) që shërben si qendër për ofrimin e asistencës juridike falas për të qytetarët, si dëshmitarë dhe viktime të korrupsionit.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Autori: Albesa Humolli
Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Shënim: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Të rinjtë dhe Shoqëria Civile për Integritet" [Eng: Youth and Civil Society for Integrity], i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe jo doemos reflekton qëndrimet e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).



PËRMBAJTJA

06 LISTA E SHKURTESAVE

07 I. MOHIMI I TË DREJTËS NË PENSION BAZIK PËR KATEGORITË E DALA NGA LUFTA

11 II. REKRUTIMI PA MERITA NË SEKTOR PUBLIK



Lista e shkurtesave

- ALAC** Qendra për Ndihmë Juridike Falas
- GJEDNJ** Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- KDI** Instituti Demokratik i Kosovës
- MFPT** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve



01

Mohimi i të drejtës
në pension bazik për
kategoritë e dala nga lufta



Më shumë se 50 qytetarë përfitues të skemave së pensioneve për kategoritë e dala nga lufta, nga muaji dhjetor 2023 e përgjatë gjithë vitit 2024, i janë drejtuar Qendrës për Ndihmë Juridike Falas (ALAC) në kuadër të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për të realizuar të drejtën e tyre në pension bazik apo të moshës.

Këta qytetarë të gjithë përfitues të njërës prej kategorive të pensioneve që përfshin skema e pensione për kategoritë e dala nga lufta, pavarësisht se kanë arritur moshën e pensionimit dhe përmbushin kriteret për të përfituar pensionin bazik, ata janë detyruar të heqin dorë nga kjo e drejtë.

Mohimi i së drejtës në pensionin bazik/të moshës kësaj kategorie të qytetarëve, i'u është bërë nën pretekstin se të njëjtin janë veçse përfitues të njërës prej skemave pensionale të financiare nga shteti dhe si të tillë nuk mund të përfitojnë edhe pensionin e moshës. Për kufizimin e kësaj të drejte, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) thirret në ligjin në fuqi për skemat pensionale që kufizon të drejtën e një personi që të jetë përfitues i skemave bazë të pensionit dhe ndonjë skemë tjetër të veçantë pensionale që menaxhohet nga ministria.¹ Në këtë drejtim qëndrimi zyrtar i MFPT është që një qytetarë nuk mund të realizojë dy të drejta/pensione nga buxheti i shtetit por mbetet në fuqi e drejta/pensionin më i favorshëm, me mundësi të përzgjedhjes nga pala se cilën të drejtë nga pensioni dëshiron të realizoj.

Megjithatë, ky interpretim dhe zbatim i ligjit është problematik dhe i kontestueshëm. Ligji i veçantë që rregullon të drejtat pensionale për kategoritë e dala nga lufta, në nenin 23 të tij, parashikon qartë se përfituesit e pensionit bazik kanë të drejtë të marrin edhe përfitimet e pensioneve për kategoritë e dala nga lufta.² Ky ligj, që ka statusin e një ligji të veçantë – lex specialis – në raport me ligjin bazë për skemat pensionale, u njeh përfituesve të drejtën për të marrë të dy pensionet njëkohësisht.

Për më tepër, asnjë dispozitë e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili është miratuar më vonë se ligji për kategoritë e dala nga lufta, dhe as ndonjë akt tjetër juridik, nuk ka shfuqizuar nenin 23 të këtij ligji të veçantë. Andaj, nga një këndvështrim ligjor, të dyja të drejtat duhet të gëzohen njëkohësisht dhe nuk ka bazë ligjore për mohimin e njërës prej tyre.

Zbatimi dhe interpretimi i gabuar i dispozitave ligjore nga ana e Departamenteve të Pensioneve në MFPT ka qenë objekt i shqyrtimit edhe nga gjykatat e rregullta në Kosovë³, përfshirë Gjykatën Supreme. Vendimet gjyqësore,

KUR INSTITUCIONET HESHTIN DHE DREJTËSIA VONON

përfshirë edhe ato të Gjykatës Supreme si autoriteti më i lartë gjyqësor, kanë vërtetuar se ky interpretim është në kundërshtim me të drejtat themelore të qytetarëve dhe me kuadrin ligjor në fuqi.⁴

Gjykata Supreme ka theksuar në vendimet e saj se e drejta në pension bazik apo të moshës përbën një të drejtë themelore, e cila nuk mund të ndahet nga pensionet e tjera. Sipas gjykatës kjo e drejtë është e garantuar jo vetëm nga legjislacioni vendor, por edhe nga praktika gjyqësore ndërkombëtare, përfshirë vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në vendimin e saj, Gjykata Supreme sqaron qartë se kur një qytetar plotëson kushtet për të qenë përfitues i skemës së pensionit bazik dhe njëkohësisht përfitues i ndonjë skeme tjetër pensionale (si veterani i luftës, invalidi, apo viktimat civile e luftës), neni 16 i Ligjit për Skemat Pensionale nuk mund të përdoret si bazë ligjore për refuzimin e së drejtës në pension bazik. Kjo dispozitë nuk ka fuqi të mbivendoset mbi të drejtën ligjore të qytetarëve për të përfituar pensionin bazik dhe atë tjetër, sidomos kur këto të drejta burojnë nga ligje të ndryshme që përcaktojnë qartë përfitimet dhe kushtet për to.⁵

Pavarësisht këtij qëndrimi të qartë nga ana e gjyqësorit, MFPT ka vazhduar të interpretojë dhe zbatojë ligjin në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, duke u thirrur në mënyrë të pasaktë në nenin 16 të Ligjit për Skemat Pensionale. Ky interpretim ka rezultuar në mohimin e së drejtës së qytetarëve për të përfituar pensionin bazik, një veprim që jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi por bie në ndesh edhe me vetë praktikën e konsoliduar gjyqësore.

Gjatë vitit 2024, Qendra për Ndihmë Juridike Falas ka trajtuar një numër të madh të ankesave të qytetarëve lidhur me mohimin e së drejtës për përfitimin e pensionit bazik. Bazuar në fluksin e madh të ankesave, që kishin të njëjtin objekt të shqyrtimit, KDI-ALAC ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për identifikimin dhe adresimin e kësaj situatë. Pas shqyrtimit të hollësishëm të çdo rasti, është evidentuar se Departamentet e Pensioneve në Ministrinë e Fi-

nancave, Punës dhe Transfereve (MFPT) janë duke zbatuar në mënyrë të gabuar dhe arbitrare legjislacionin në fuqi, duke u mohuar qytetarëve të drejtën e tyre të garantuar në pension bazik.

Në përgjigje të kësaj problematike, KDI-ALAC ka përgatitur një shkresë grupore drejtuar ministrin përgjegjës të MFPT, duke kërkuar njohjen e kësaj të drejte për të gjithë qytetarët që i janë drejtuar qendrës dhe që plotësonin kushtet sipas legjislacionit. Megjithatë, përkundër përpjekjeve dhe komunikimeve të njëpasnjëshme, MFPT nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me trajtimin e këtyre rasteve.⁶

Në mungesë të reagimit institucional dhe për të inicuar konfliktin administrativ në mënyrë që e drejta të kërkohej në rrugë ligjore, KDI-ALAC ka përgatitur dhe dorëzuar 38 aplikime për pension bazik për qytetarët të cilat janë dorëzuar në Departamentet e Pensioneve në regjionet përkatëse. Ashtu edhe siç pritej nga praktikat e mëhershme, të gjitha aplikimet janë refuzuar nga Departamentet e Pensioneve të MFPT, me arsyetimin se qytetarët tashmë janë përfitues të një skeme tjetër pensionale dhe, për këtë arsye, nuk mund të përfitojnë edhe pensionin bazik. Për secilin rast, KDI-ALAC ka asistuar qytetarët në përgatitjen e ankesave kundër vendimeve mbi refuzim të së drejtës për pension bazik. Pasi MFPT ka refuzuar përfundimisht këto ankesa edhe me vendim të shkallës së dytë në procedurë administrative, rruga e vetme ligjore ka qenë adresimi i çështjes në gjykatë.

Gjatë periudhës mars-qershor 2024, Qendra për Ndihmë Juridike Falas ka përgatitur dhe dorëzuar 32 padi⁷ në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke asistuar qytetarë të cilëve u është mohuar padrejtësisht e drejta në përfitimin e pensionit bazik. Megjithatë, deri në fund të vitit 2024, asnjë nga këto padi nuk ka arritur të trajtohet në shqyrtim gjyqësor. Kjo situatë ka krijuar një gjendje të pasigurt ligjore për qytetarët dhe ka nxjerrë në pah dobësitë strukturore të drejtësisë administrative në Kosovë.

Sipas të dhënave të konfirmuara nga Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, deri në mua-

¹ Neni 16, i Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

² Neni 23, par.2, i Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre

³ Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.280/17 i datës 04.02.2020.

⁴ Aktgjykim i Gjykatës Supreme ARJ nr. 77/2021 i datës 17.08.2021.

⁵ Po aty.

⁶ Kërkesë për njohje të së drejtës së pensionit bazik për përfituesit e skemave të pensioneve të kategorive të dala nga lufta, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dërguar në shkurt 2024.

⁷ Databaza e rasteve të KDI-ALAC.



Jin tetor 2024, janë regjistruar 1,829 raste të ngjashme që lidhen kryesisht me çështjen e dy pensioneve.⁸ Ky fluks i jashtëzakonshëm ka mbingarkuar në mënyrë kritike kapacitetet e këtij departamenti, duke shkaktuar vonesa të mëdha dhe duke penguar shqyrtimin efikas të lëndëve. Situata përkeqësohet nga fakti se Departamenti Administrativ aktualisht funksionon vetëm me 7 gjyqtarë, një numër shumë i pamjaftueshëm për të përballuar ngarkesën e lartë të punës.⁹

Në këtë kontekst, është evidente që mbingarkesa e gjykatës nuk është një problem i izoluar, por një simptomë e një mungese më të thellë të efikasitetit administrativ. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në vend që të trajtonte këto çështje në mënyrë efektive dhe të zbatonte ligjin në përputhje me interpretimet e gjykatave, i ka transferuar këto lëndë në sistemin gjyqësor, duke shtuar barrën në një sistem tashmë të mbingarkuar. Refuzimi i vazhdueshëm i ministrisë për të trajtuar çështjet në nivel administrativ ka dëmtuar rëndë interesat e qytetarëve dhe ka minuar besimin në institucionet publike.

Për më tepër, MFPT ka adoptuar një qëndrim të heshtjes së qëllimshme kur është ballafaquar me pyetje apo kërkesa nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile¹⁰ lidhur me mohimin e së drejtës për pension të dyfishtë. Ky qëndrim reflekton mungesën e transparencës dhe llogaridhënies, duke krijuar një situatë frustrimi dhe pasigurie për qytetarët e prekur. Në mënyrë të përsëritur, MFPT ka injoruar shqetësimet e ngritura dhe nuk ka ofruar zgjidhje për problemet që burojnë nga zbatimi i gabuar i nenit 16 të Ligjit për Skemat Pensionale.

Heshtja e qëllimshme e MFPT është veçanërisht shqetësuese kur merret parasysh fakti se këto çështje prekin disa nga grupet më të cenueshme të shoqërisë, përfshirë veteranët, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të dala nga lufta, të cilët mbështeten në këto pensione për mbijetesën e tyre. Mohimi i të drejtës për të përfituar nga pensioni bazik dhe ai specifik ka krijuar një barrë të rëndë ekonomike dhe sociale për këta individë dhe familjet e tyre, duke minuar parimet e drejtësisë sociale dhe barazisë që shteti pretendon të promovojë.

Ky qëndrim i MFPT reflekton gjithashtu një mungesë të përgjegjësisë institucionale për të marrë në konsideratë dhe për të zbatuar praktikën gjyqësore të konsoliduar, e cila është obliguese për të gjitha institucionet publike. Andaj praktika si këto, tregojnë për nevojën urgjente për reforma institucionale dhe për vendosjen e mekanizmave që garantojnë llogaridhënie dhe transparencë. Vetëm përmes një veprimi të tillë mund të sigurohet që qytetarët të mos përballen më me shkelje të të drejtave të tyre dhe drejtësi të vonuar.



02

Rekrutimi pa merita në sektor publik

⁸ Kërkesë për qasje në dokumente publike për Gjykatën Themelore në Prishtinë, e datës 11.11.2024.

⁹ Qeveria e Kosovës është duke shkelur të drejtat e pensionistëve për pension të dyfishtë, Kosova Law Institute. <https://kli-ks.org/qeveria-e-kosoves-eshte-duke-shkelur-te-drejtat-e-pensionisteve-per-pension-te-dyfishte/>

¹⁰ Kërkesë për qasje në dokumente publike për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, e datës 15.11.2024.



Gjatë vitit 2024, Qendra për Ndihmë Juridike Falas (KDI-ALAC) ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankesash nga qytetarët në lidhje me proceset e rekrutimit dhe menaxhimit të marrëdhënies së punës në sektorin publik. Vetëm përgjatë këtij viti mbi 25 qytetarë¹¹ i janë drejtuar ALAC me ankesa që kryesisht kishin të bënin me fazën e konkursit, ku janë evidentuar raste të shkeljeve të procedurave, mungesës së transparencës dhe praktikave diskriminuese. Situata të tilla kanë ngritur shqetësime serioze për integritetin dhe barazinë në mundësitë e punësimit në administratën publike në vend.

Rekrutimi në administratën publike është një çështje thelbësore, pasi ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve publike dhe në besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. Edhe pse procedurat e rekrutimit janë të dizajnuara për të siguruar që individët që punësohen në pozita publike të kenë kualifikimet dhe meritat e nevojshme, shpesh herë janë evidentuar parregullsi dhe shkelje që dëmtojnë integritetin dhe efikasitetin e këtij procesi. Përkundër reformimit të procesit të rekrutimit, zbatimit të ri të modelit të centralizuar të rekrutimit dhe njëkohësisht rekrutimit përmes portalit elektronik, rastet e raportuara në ALAC kanë treguar se ende vazhdojnë të ekzistojnë parregullsi dhe shkelje të procedurave. Një prej shkeljeve më të shpeshta ka qenë mosrespektimi i kritereve të konkursit, duke përfshirë përzgjedhjen e kandidatëve që nuk i përmbushnin kushtet e kërkuara, ose anashkalimin e kandidatëve me kualifikime më të mira në favor të atyre me kualifikime më të dobëta. Po ashtu, disa ankesa janë ngritur lidhur me ndërhyrjet politike dhe favorizimet, të cilat kanë ndikuar në vendimet përfundimtare të procesit të rekrutimit.

Një rast suksesi i trajtuar gjatë vitit 2024, nga Qendra për Ndihmë Juridike Falas, ka të bëjë me shkeljet e raportuara në lidhje me një konkurs publik të organizuar nga një komunë për rekrutimin e stafit arsimor në një nga shkollat e saja publike. Ky rast ka filluar me ankesën e një qytetari, i cili ishte vetë aplikantë në këtë konkurs dhe që raportoi se procesi i përzgjedhjes nuk kishte qenë i drejtë, meritore dhe i bazuar në kualifikime objektive. Sipas qytetarit, komisioni i vlerësimit kishte treguar favorizim ndaj një kandidati tjetër, për shkak të lidhjeve familjare që ky kandidat kishte me kryetarin e komunës.

Pas pranimit të raportimit, ALAC ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet përkatëse të konkursit, duke përfshirë kriteret e vlerësimit dhe dosjet e kandidatëve. Përmes kërkesës për qasje në dokumente publike,¹² ALAC ka siguruar dhe analizuar format e vlerësimit dhe dosjet e aplikimit për çdo kandidat, si dhe ka vërtetuar se procesi i përzgjedhjes dhe rekrutimit për këtë konkurs kishte evidentuar disa parregullsi. Ishte e qartë se qytetari që bëri raportimin ishte injoruar qëllimisht në disa kategori të vlerësimit, ndërkohë që komisioni kishte favorizuar kandidatin tjetër, duke e vlerësuar atë me pikë apo edhe me pikë

11 Databaza e rasteve ALAC

12 Kërkesë për qasje në dokumente publike e datës 15 nëntor 2024.

më të larta – në mënyrë që t'i mundësonin përzgjedhjen e tij si fitues, pavarësisht se nuk i përmbushte kriteret e kërkuara.

Në përputhje me afatet ligjore, ALAC ka përgatitur dhe dorëzuar një ankesë formale kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të komunës. Pavarësisht shkeljeve të paraqitura në ankesë dhe provave të bashkëngjitura, komisioni i vlerësimit të komunës e hodhi poshtë ankesën, duke e cilësuar atë si të pabazuar, dhe la në fuqi vendimin për përzgjedhjen e kandidatit. Meqenëse, ky vendim i komisionit mund të ankohej vetëm nëpërmjet rrugës gjyqësore, ALAC, brenda afateve ligjore ka grumbulluar të gjitha faktet dhe provat përkatëse që vërtetojnë shkeljet e procedurave dhe abuzimet gjatë konkursit, dhe ka referuar çështjen përmes një padie në gjykatë.

Gjykata, në lidhje me çështjen e ngritur, e ka aprovuar padinë dhe ka marrë vendim në të cilin ka obliguar institucionin, konkretisht komunën, që të anulojë vendimin për përzgjedhjen e kandidatit në këtë konkurs. Gjithashtu, komuna është obliguar që të rishqyrtohen të gjitha aplikimet dhe vlerësimet e bëra, brenda një periudhe prej 7 - ditësh. Pas kësaj, duke u bazuar në pikët e mbledhura, komisioni është detyruar të përcaktojë kandidatin që ka arritur pikët më të larta dhe që plotëson kriteret e konkursit.¹³ Ky proces i ri i vlerësimit i mundësoi qytetari që kishte raportuar në ALAC të shpallej fitues dhe të përzgjidhej për pozitën në fjalë, në përputhje me meritat dhe kualifikimet e tij.

Një rast tjetër që gjeti epilog gjatë vitit 2024, ka të bëjë me një raportim në lidhje me një konkurs tjetër të shpallur nga një institucion publik. Rasti ishte iniciuar nga një qytetarë në fund të vitit 2023 në lidhje me disa shkelje në procedurën e rekrutimit sipas një konkursi të brendshëm publik. Pas marrjes së raportimit, qendra ka kontaktuar institucionin dhe përmes kërkesës për qasje në dokumente publike ka kërkuar qasje në dosjen e konkursit dhe të aplikantëve. Nga ku ka rezultuar se konkursi dhe e gjitha procedura e vlerësimit dhe rekrutimit ka përmbajtur disa shkelje dhe parregullsi në raport me rregulloret në fuqi që rregullon themelimin dhe avancimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

13 Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Gjakovë, mars 2024.

14 Neni 6, i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Një nga gjetjet kryesore ishte se konkursi i shpallur nga ky institucion ishte hapur vetëm për 14 ditë, duke shkelur kërkesën ligjore që konkurset për pozita publike duhet të jenë të hapura për 15 ditë.¹⁴ Për më tepër nga dosjet e aplikimit u ka zbuluar se tre aplikime ishin paraqitur pas afatit zyrtar të mbylljes së konkursit ndërsa pikërisht kandidatit që ishte përzgjedhur për këtë pozitë, ishte një nga ta.

Duke marrë për bazë shkeljet e shumta dhe provat që vërtetoni që konkursi ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, qendra ka ankimuar vendimin e komisionit vlerësues ndërsa paralelisht ka paraqitur ankesë edhe pranë Inspektoratit të Punës. Pavarësisht se institucioni e hodhi poshtë ankesën e KDI-ALAC si të pabazuar, Inspektorati i Punës kreu një hetim të thelluar, duke konfirmuar gjetjet tona. Raporti përfundimtar i Inspektoratit të Punës vërtetoi shkeljet e konkursit, ndërsa obligoi institucionin që të korrigjoj shkeljet nën kërcënimin e vendosjes së masave ndëshkuese financiare. Si rezultat, për shkak të shkeljeve të shumta, institucioni publik u detyrua të anulojë në tërësi konkursin dhe ta shpallë përsëri pozitën në fjalë.

Këta janë raste që japin një shembull të qartë të rëndësisë së transparencës dhe integritetit në proceset e rekrutimit në sektorin publik, ndërsa theksojnë nevojën për më shumë mekanizma mbikëqyrës dhe përkushtim të institucioneve për të siguruar që proceset e konkurrencës të jenë të drejta, transparente dhe të bazuara në meritat. Përmes këtyre rasteve, KDI-ALAC ka kontribuar në forcimin e besimit të qytetarëve në proceset e rekrutimit në administratë publike, duke garantuar që ky sistem të bëhet më i drejtë, më i përgjegjshëm dhe më i besueshëm për të gjithë.

RAPORTO KORRUPSIONIN

THIRR

**0800
77 777**

ose online në linkun

<https://raporto.kdi-kosova.org/>

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI-së, ju lutem vizitoni:
www.kdi-kosova.org